



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS



**Kryetari i Komunës** në bazë të neni 8 paragrafi 3.2, të rregullores 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, shpall këtë :

## THIRRJE PUBLIKE

Për dy përfaqësues nga grupi i Ekspertëve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues.

Kryetari i Komunës ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve, të publikuar me datë: 18.04.2024 me titull:

### **Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare**

Ftohen të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar duhen t'i plotësojnë këto kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë);
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë);
3. Njohja e dokumenteve strategjik dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë);
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë);
5. Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20pikë);
- 6.Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10pikë);
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15pikë).

**Afati i aplikimit: 18.04.2024 deri 06.05.2024.**

**Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kritere:**

Duhet të kenë diplomë universitare;

Të kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. UÇK 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e Kryetarit të Komunës